



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

Drejtoria e Politikave & Zhvillimit të Hidrokarbureve

**URDHËR**

**Nr. 6, Datë. 09.01.2015**

**PËR KONTROLLIN E STANDARDEVE TEKNIKE TË NAFTËS DHE  
NËNPRODUKTEVE TË SAJ, PROCEDURAT DHE TARIFAT PËRKATËSE.**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 23 të ligjit nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, të VKM nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzine dhe diezel”, dhe të VKM nr. 781, datë 14.11.2012 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”,

**URDHËR O J:**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Kontrolli i cilësisë së naftës dhe nënprodukteve të saj bëhet në zbatim të VKM nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzine dhe diezel”, të VKM nr. 781, datë 14.11.2012 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)” dhe të metodikave të testimi të standardeve përkatës në fuqi, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve, në Laboratorin e akredituar të Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës (ISHP) ose në laboratorë të tjerë të akredituar.

**II. PROCEDURA E MARRJES SË MOSTRËS**

1. Kontrolli cilësor i naftës bruto dhe nënprodukteve të saj bëhet nëpërmjet marrjes së mostrës, sipas Standardit Shtetëror në fuqi S SH EN ISO 3170:2005 “Metodat e provës për naftën dhe produktet e saj - Lëngjet e naftës - Marrja e mostrave me dorë”, dhe S SH EN ISO 3171:2002 “Metodat e provës për naftën dhe produktet e saj - Lëngjet e naftës - Marrja automatike e mostrave me tubacion”.
2. Marrja e mostrës bëhet për naftën bruto dhe nënproduktet e saj për:
  - sasitë e prodhuara në vend,
  - sasitë e importuara para zhdoganimit,

- sasi të në proces transportimi, depozitimi dhe tregtimi si kontroll periodik të detyrueshëm të subjekteve që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

ISHP fillon procedurën e mostërmarrjes për sasi të prodhuara në vend dhe ato para zhdoganimit pasi të paktën dy ditë pune më parë të jete njoftuar me shkrim nga subjekti përkatës. IQT realizon procesin e mostërmarrjes vetëm për subjektet, të cilat nuk kanë detyrime financiare ndaj saj, në mënyrë përfundimtare.

3. Sasia e mostrës e nevojshme për kryerjen e analizave e ruajtjen e saj të jetë:

a. Për kategorinë 0/A (nafte bruto), II/A, II/B, II/C, III/A, III/C, III/Ç, IV/B. (benzinë automjetesh, benzine mjetesh të fluturimit ajror, nënprodukte të tjera, të lëngshme si: benzol, toluol, ksilol, solvent, white spirit, gazoil automjetesh, lëndë djegëse për mjetet e fluturimit ajror, lëndë djegëse për përdorim termik civil dhe ose industrial, solar,), V/A, V/B, (bitum, mazut) dhe IV/A (vajrat):

- 3 (tre) mostra dhe të shtohet 1 mostër në rastin e importit me kapacitet 1 litër secila, të ambalazhuar në 3 ose 4 mostra mbajtëse, nga të cilat 2 (dy) litra për analizat dhe ruajtje në laborator në ISHP, 1 (një) litër subjektit dhe 1 (një) litër doganës për rastet e importimit para zhdoganimit.

b. Për kategorinë I/B (gazin e lëngshëm të naftës):

- 3 (tre) mostra dhe të shtohet 1 mostër në rastin e importit në bombola në sasinë deri në 3 litra secila, nga të cilat 2 (dy) bombola për analizat dhe ruajtje në laborator në ISHP, 1 (një) bombol për subjektit dhe 1 (një) bombol doganës për rastet e importimit para zhdoganimit.

4. Mostrat merren nga punonjësit e ISHP, të pajisur me autorizim nga ana e titullarit të institucionit, në prani të paktën të njërit prej përfaqësuesve të autorizuar të subjektit si më poshtë:

a. Për rafineritë e naftës dhe impiantet e përpunimit të nënprodukteve të saj, marrja e mostrave behet sipas urdhrit të përbashkët të ish-METE dhe MF, nr.4288 dhe 4267 datë 30.4.2010.

b. Për shoqëritë e tregimit me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të saj:

- Për sasi të e importit në pikat doganore, për çdo produkt dhe për çdo ndarje fizike të mjetit transportues (anije, vagon/cisterne hekurudhore, autobot, fuçi). Për rastin e importit të GLN me vagona cisterne dhe/ose me autobot, për arsye sigurie teknike, mostërmarrja të behet në çastin e shkarkimit të këtij produkti në depozita. Në rastin e importit të lubrifikanteve mostërmarrja bëhet për çdo lloj lubrifikanti më vete.

-Për sasi të e disponueshme për tregtim në tregun e brendshëm, në depozitat e shoqërive të tregimit me shumicë (në pronësi ose përdorim) në çdo 4 (katër) muaj për çdo produkt,

-Për sasi të që transportohen me automjetet në pronësi dhe ose me kontratë qeraje, me sondazhe me urdhër të veçantë nga Kryeinspektori.

c. Për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikantë, si edhe për stacionet dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim rezidencial të konsumatorëve, të bëhet një herë në vit për çdo produkt.

d. Për çdo rast të veçantë që me urdhër të kryeinspektorit merret mostër për sondazh, brenda ose jashtë orarit të punës. Në këtë rast përfshihet edhe kontrolli për cilësinë e nënprodukteve të naftës që përdorin konsumatorët e mëdhenj.

5. Ambalazhet për marrjen e mostrave të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj të jenë të pastra, të thata dhe për një përdorim, të sigurohen nga ISHP sipas kushteve të mëposhtme:

- Enë metalike me volum 1 lit., sipas standardit EN ISO 3171 (naftë bruto, benzinë, mazut, bitum).
- Enë plastike me volum 1 lit., sipas standardit EN ISO 3170 (për produktet e tjera të pa cituara më lart në këtë pikë).
- Bombola metalike me volum deri në 3 lit., sipas standardit ASTM D 1265, seria 21600 -3 për Gazin e Lëngshëm të Naftës (GLN).

- a. Mostra e marrë hermetizohet, sekretohet dhe pajiset me etiketën përkatëse të identifikimit.
- b. Për çdo rast marrje mostre, mbahet proces-verbal. Nëse subjekti refuzon ta nënshkruajë proces-verbalin, inspektori bën shënimin “refuzon firmën”, duke njoftuar Kryeinspektorin.
- c. Në rast se subjekti nuk lejon të merret mostër, ISHP të bashkëpunojë me organet e rendit për realizimin e të drejtave dhe përgjegjësive sipas nenit 23 të ligjit 8540 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.
- ç. Mostra administrohet në ISHP, në përputhje me rregullat e funksionimit të këtij institucioni.
- d. Mostrat në ruajtje, në ISHP dhe në subjekt, analizat e të cilave kanë rezultuar jo në përputhje me standardet përkatëse, likuidohen vetëm mbas zgjidhjes përfundimtare të ankesës së subjektit sipas afateve të caktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. ISHP i jep subjektit përgjigjen e analizave për çdo produkt për të cilën është marrë mostra, sipas afateve kohore si vijon:

- brenda 12 orëve nga marrja e mostrës para zhdoganimit për anijet (tankera) në терминаlet detare të miratuara.
- brenda një dite, nga marrja e mostrës para zhdoganimit në depozitat e porteve detare të miratuara.
- brenda tre ditëve pune nga data e marrjes së mostrës para zhdoganimit për mjetet e transportit tokësor dhe hekurudhor. Për këto mjete, për efekt të kryerjes së procedurave doganore, konfirmimi për cilësinë e produktit bëhet menjëherë mbi bazën e certifikatës së origjinës dhe vërtetohet përfundimisht nëpërmjet rezultateve të analizave brenda afateve kohore të mësipërme.
- brenda pesë ditë pune nga data e marrjes së mostrës në subjektet e tregtimit me shumicë dhe me pakicë si dhe klientët e mëdhenj industrialë.

7. Ankimimi për rezultatin e analizave dhe sanksionet lidhur me to:

- a. Për rastet, kur subjekti ka kundërshtim për rezultatet e analizave ose për sanksionin e dhënë nga ISHP, ka të drejtë të ankohet tek Kryeinspektori, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të përgjigjes së analizës për produktin për të cilin është marrë mostra ose njoftimin për sanksionin e vendosur.
- b. Mbas këtij afati, subjekti humbet të drejtën e ankimit tek Kryeinspektori.
- c. ISHP kthen përgjigje brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankesës.
- ç. Zgjidhja e konfliktit bëhet në përputhje me ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”

### **III. PAGESAT PËR KRYERJEN E ANALIZAVE**

1. Sasia e produkteve që mostrohen për kryerjen e analizave merret pa pagesë nga ISHP.

2. Tarifat për kryerjen e analizave laboratorike janë sipas specifikimeve të dhëna në Aneksin Nr. 1, bashkëlidhur këtij Urdhri.

3. Pagesa e tarifës për kryerjen e analizave laboratorike përballohen nga subjekti në:

- rastin e futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- rastin e kontrollit të cilësisë për sasinë e prodhuara në vend;
- rastin e kontrolleve periodike të detyrueshme;
- rastin kur rezultojnë shkelje në treguesit e cilësisë.
- çdo rast tjetër kur i kërkohet ISHP nga vetë subjekti, për kryerjen e analizave laboratorike.

4. Pagesa e tarifës është e detyrueshme dhe bëhet brenda 15 ditëve nga data e dhënies së përgjigjes së analizës subjektit, ndërsa për importet pagesa bëhet para zhdoganimit.

#### **IV. DOKUMENTACIONI PËR MARRJEN E MOSTRËS DHE KRYERJEN E ANALIZAVE**

Ky dokumentacion të përbëhet nga:

1. Autorizimi i titullarit të institucionit për inspektim dhe marrje mostrash,
2. Proces-verbali për marrjen e mostrës,
3. Fotokopje e faturës së blerjes që përshkruan sasinë e produktit të mostruar,
4. Certifikata e origjinës dhe cilësisë për produktin e mostruar lëshuar nga shitësi,
5. Raport i përgjigjes së analizave për produktin e mostruar nga laboratorit i ISHP,
6. Faturë për arkëtimin e pagesës së tarifës përkatëse.

IV. Urdhri i Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës nr.166, datë 01.07.2004 “Për kontrollin e cilësisë, mënyrën e marrjes së mostrës, sasinë e saj, pagesat dhe dokumentacionin përkatës , si dhe për kontrollin e respektimit të normave e kushteve teknike në instalimet e naftës, gazit dhe nënproduktet e tyre”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**DAMIAN GJIKNURI**

TABELA E TARIFAVE TË ANALIZAVE LABORATORIKE

PRODUKTI	PARA ZHDOGANIMIT					NË TREGUN E BRENDSEHM			ANALIZA PËR TË TRETET
	PËR ÇDO MJET TRANSPORTI DETAR, HEKURUDHOR DHE NË DEPOZITA				PËR ÇDO AUTOMJET TË TRANSPORTI T TOKESOR	SHOQERI ANONIME SH.A.	SHOQERI ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR SH.P.K. Kur mostermarrja behet prane depozitave/magazinave te vendosura ne :		
	DERI 1000 TON	1001 - 5000 TON	5001-10 000 TON	MBI 10 000 TON			BASHKITE DHE AKSET KRYESORE RRUGORE	KOMUNAT DHE RRUGET RURALE	SIPAS KERKESES
NAFTE - BRUTO	75 000	100 000	150 000	200 000	10 000	75 000			75 000
G . L . N .	50 000	75 000	100 000	170 000	10 000	50 000	40 000	25 000	25 000
BENZINE - AUTOMJETI / BIOETANOL	85 000	130 000	150 000	200 000	14 000	100 000	50 000	30 000	35 000
GAZOIL / BIODIEZEL	80 000	100 000	150 000	200 000	10 000	100 000	50 000	30 000	30 000
VAJGUR NDRIÇUES	40 000	50 000	80 000	100 000	10 000	70 000	30 000	25 000	35 000
VAJGUR AVIONESH	100 000	130 000	150 000	200 000	17 000	150 000			35 000
BENZINE AVIONESH	100 000	130 000	150 000	200 000	17 000	150 000			40 000
BENZOL,TOLUOL , KSILOL ËHITE SPIRIT,	85 000	100 000	130 000	150 000	14 000	50 000			25 000
LËNDË - DJEGESE ( SOLAR , MAZUT )	50 000	75 000	100 000	150 000	10 000	50 000	30 000	25 000	35 000
VAJ LUBRIFIKANT PER MOTORRA	60 000	80 000	100 000	120 000	10 000	40 000	20 000	20 000	30 000
VAJ LUBRIFIKANT PËR TRANSFORMATORE	70 000	90 000	110 000	120 000	15 000	50 000			25 000
VAJRA BAZË	40 000	65 000	100 000	120 000	10 000	40 000			30 000
GRASO	30 000	55 000	75 000	100 000	5 000	20 000			20 000
NENPRODUKTE TE TJERA	85 000	100 000	130 000	150 000	14 000	50 000			25 000